



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:463-01/36016, 28 Maj 2024

Në bazë të nenit 12 par.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenit 17 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, mori këtë:

VENDIM
Nr. 17/2024

Mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës -dy(sporte)le për aktivitete bankare.

1. **MIRATOHET** - Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës .
2. Komisioni vlerësues sipas këtij vendimi përbehet prej 5(pesë) anëtarëve si me poshtë:
 - 2.1. Luan Pavata anëtarë i kuvendit nga subjekti i LDK-së,
 - 2.2. Nezir Jahmurataj anëtarë i kuvendit nga subjekti i LVV-së,
 - 2.3. Edonjeta Berisha – anëtar nga ekzekutivi i komunës - drejtoresh në DI,
 - 2.4. Arianit Krasniqi – anëtar nga ekzekutivi i komunës - drejtor në DÇPJ,
 - 2.5. Naser Lajqi anëtarë nga sektori joqeveritar anëtarë.
3. Kryesuesi i Komisionit vlerësues zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të Komisionit Vlerësues.
4. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit Vlerësues janë: përpilimi i njoftimi publik me të dhënat për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës ,prezenca në ankand publik, hapja e ofertave,vlerësimi final i ofertave në pajtim me kriterët e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit ,si dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me ligjin dhe rregullore në fuqi.
5. Dërgimi të Kryetari i Komunës për miratim të ofertës se përzgjedhur për dhënien afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës dhe çështje tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni vlerësues.
6. Administrata e Komunës i ofronë përkrahje komisionit vlerësues për dhënies në shfrytëzim të pronës Komunale.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

8. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

